

KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE  
E SHQIPËRISË

**TIPIKOJA**  
**E SHËRBESAVE**  
**TË PËRDITSHME KISHTARE**  
**2021**

PUNOI: STEFAN ZHUPA

TIRANË, 2020





## MUAJI JANAR

**1. E PREMTE. RRETHPRERJA TRUPORE E ZOTIT TONË JISU KRISHT.** Shën Vasili i Madh, kryepiskop i Kapadokisë. Dëshmor Telemaku.

### **Në Mbrëmësore:**

“I BEKUAR është Perëndia ynë...”. “Ejani t’i falemi...” (3 herë), PSALMI NISTOR (Ps. 103) dhe PAQËSORET.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të shën Vasilit, të cilat bëhen 4, duke thënë të parën dy herë. “Lavdi...”, e shën Vasilit. “Tani...”, e së kremtes (kërkoji në Kremtore).

HYRJA. “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, paravargu i ditës dhe leximet biblike: (Leximi I: Gjen. 17:1-14; Leximi II: Fja. Urt. 8:22-30; Leximi III: Fja. Urt. 10:31-32; 11:2, 6-7, 19; 14:33; 22:11; Urt. Sol. 6:12-16; 7:30; 8:2-4, 7-8, 17-18, 21; 9:1-5, 10-11, 14;).

PASVARGJET e shën Vasilit, bashkë me dy vargjet e tyre:

~~~~~

Vargu I: *“Goja ime do të flasë dituri dhe mendimi i zemrës sime do të jetë plot mençuri”.*

Vargu II: *“Goja e të drejtit do të flasë urtësi, gjuha e tij do të shpallë drejtësi”.*

“Lavdi...”, e shën Vasilit. “Tani...”, e së kremtes.

PËRLËSHORJA e shën Vasilit: “Në tërë dheun...”.  
“Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes: “Fytyrë njerëzore...”.

PËRLËSHIMI: Ai që pranoi të rrethpritej trupërisht ditën e tetë për shpëtimin tonë, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë...”.

### **Në Mëngjesore:**

Pas gjashtë psalmeve, te “PERËNDIA ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e shën Vasilit: “Në tërë dheun...”. “Lavdi...”, po ajo: “Në tërë dheun...”. “Tani...”, e së kremtes: “Fytyrë njerëzore...”.

NDENJËSORET sipas radhës, si në Kremtore.

SHKALLESAT: “Që prej rinisë sime...” dhe paravargu: “Goja ime do të flasë...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor (kërkoje në datën 13 nëntor).

Pas Ungjillit lexohet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e kryepriiftit...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”.

~~~~~  
“Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i shenjtit: “Buzët të derdhën hir...”.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e shenjtit. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET dyshe: “E teri, e thau fare...” dhe “Shkoi nëpër detin...”.

MADHËSHTIMET: Pas Këngës VIII thuhet thirrja: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...” dhe, në vend të: “Më të nderuarën...”, psalet Kënga IX e të dy kanoneve dhe në fund thuhet Kënga IX e Zbritësoreve: “Asnjë gjuhë...” dhe: “O çudi pa fund...”.

DËRGIMSORJA e shenjtit dhe e së kremtes.

LAVDËRIMET: psalen 3 Vargëzimet e përshembullta, të cilat bëhen 4, duke thënë të parin dy herë: “Pate rrethprerje si çilimi...”. “Lavdi...”, e shenjtit. “Tani...”, e së kremtes (kërkoji në Kremtore).

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e së kremtes: “Fytyrë njerëzore...”.

### **Në Liturgjinë Hyjnore:**

ANDIFONET e së kremtes. Refreni i Andifonit II: “Shpëtona, o i Bir’ i Perëndisë, që u rrethpreve trupërisht, ne që të psalim: Alilua”.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona, o i Bir’ i Perëndisë, që u rrethpreve trupërisht, ne që të psalim: Alilua”.

~~~~~

Pas HYRJES psalet Përlëshorja e së kremtes: “Fytyrë njerëzore...”, e shën Vasilit: “Në tërë dheun...” dhe e shenjtorit të kishës. Shkurtorja e së kremtes: “Zoti i të gjithave...” (në Kremtore).

APOSTULLI i datës 1 janar (Kol. 2:8-12).

UNGJILLI i njëjtë (Llk. 2:20-21, 40-52).

Vazhdon Liturgjia Hyjnore e Shën Vasilit të Madh.

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet tropari: “Me ty gëzohet, o Hirplote, tërë krijesa...”

Te DIPTIKËT, psalet Madhështimi i shën Vasilit: “Lëçitësin qiellor...”.

KUNGATORJA: “Lavdëroni Zotin...”.

Në vend të: “PAMË DRITËN...”, psalet Përlëshorja e së kremtes: “Fytyrë njerëzore...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

PËRLËSHIMI si në Mbrëmësore.

**Shënim:** Nga data 2 deri në datën 5, në Mëngjesore psalen vetëm Zbritësoret e para: “E teri, e thau fare...”. Nëse gjatë këtyre ditëve kryet Liturgjia Hyjnore, atëherë në të psalet Shkurtorja parakremtuese: “Në Jordan afrohet sot...” (kërkoje te Kremtorja, fq. 475).

~~~~~

**2. E SHTUNA PARA THEOFANISË.** Silvestri i Romës. Dëshmorët Theagjeni, Theopisti, Sergji dhe Theopemti. Kozmai i Konstandinopojës. Oshënar Nili në Orikum. Oshënar Serafimi i Sarovit.

**Mbrëmësorja** e përditshme (në fund të Mbrëmësores psalet Përlëshorja parakremtuese: “Përgatitu, Zabulon...” [1 herë – kërkoje në Kremtore, fq. 475).

**Mëngjesorja** e përditshme (në fillim të Mëngjesores, te “Perëndia është Zoti...”, psalet Përlëshorja parakremtuese: “Përgatitu, Zabulon...” [2 herë – kërkoje në Kremtore, fq. 475).

Nëse pas Mëngjesores nuk kryhet Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore, atëherë leximet biblike lexohen në fund të Mëngjesores:

APOSTULLI i së shtunës para Theofanisë (1 Tim. 3:13-4:5).

UNGJILLI i së shtunës para Theofanisë (Mtth. 3:1-6).

Nëse pas Mëngjesores kryhet Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore, atëherë Apostulli dhe Ungjilli lexohen në Liturgji. Gjithashtu, në Liturgji thuhet Përlëshorja

~~~~~

parakremtuese: “Përgatitu, Zabulon...” dhe Përlëshorja e shenjtit të kishës, si edhe Shkurtorja parakremtuese: “Në Jordan afrohet sot...”.

**3. E DIELA PARA THEOFANISË.** Profeti Malakia. Dëshmor Gordi. Oshënare Gjenovefa. Tingulli Tërthor I. Ungjilli mëngjesor VIII.

**Në Mbrëmësore:**

“I BEKUAR është Perëndia ynë...”, “Ejani t’i falemi...” (3 herë), PSALMI NISTOR (Ps. 103) dhe PAQËSORET.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 6 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e përshembullta parakremtuese, që bëhen 4 (i pari thuhet 2 herë): “Ejani nisuni...”. “Lavdi...”, Lavdia parakremtuese: “Mbreti, ja ku na vjen...” (kërkoji në Kremtore, fq. 476-477). “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike në të njëjtin tingull me Lavdinë: “Shkoi hija e ligjit...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Lavdia parakremtuese: “Krishti na u faneps...” (Kremtore, fq. 477).



~~~~~

**PËRLËSHORJA** ngjallësore: “Fjalën e panisëshme...”. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Përlëshorja parakremtuese: “Përgatitu, Zabulon...”.

**Në Mëngjesore:**

Pas gjashtë psalmeve, te “**PERËNDIA ËSHTË ZOTI...**”, Përlëshorja ngjallësore: “Fjalën e panisëshme...”. “Lavdi...”, po ajo: “Fjalën e panisëshme...”. “Tani...”, Përlëshorja parakremtuese: “Përgatitu, Zabulon...”. .

**NDENJËSORET** ngjallësore, sipas radhës, por në vend të Hyjlindësoreve të stikologjisë (grupit) së parë, thuhet Hyjlindësorja e Përlëshoreve: “Gëzohu, derë e Zotit, e pakaluar...”.

**BEKIMTORET** ngjallësore, **SHKALLESAT**, **DËGJIMI DHE PARAVARGU** i tingullit.

**SHKURTORJA** dhe **SHTËPIA** e tingullit. **SINAKSARI** i ditës.

**ZBRITËSORET**: “E teri, e thau fare...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe **UNGJILLI** mëngjesor ngjallësor VIII.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet **PSALMI 50**. Pas Psalmit 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...” etj.

~~~~~

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe Kënga IX e Zbritësoreve: “Asnjë gjuhë në botë...”.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore VIII dhe Dërgimsorja parakremtuese: “Ja zëri i thërritësit gjëmoi...” (Kremtore, fq.480).

LAVDËRIMET: psalen 4 Vargëzimet ngjallësore dhe 4 Vargëzimet e vetëmelodishme parakremtuese: “Shkoni përpara...” (Libri i të kremteve të mëdha, fq. 130-131). “Lavdi...”, lavdia mëngjesore VIII. “Tani...”, “E Përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe “Sot erdhi shpëtimi...”.

### **Në Liturgji:**

ANDIFONET e së dielës.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi...”, “Shpëtona, o i Bir’ i Perëndisë, që u ngjalle...”.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Fjalën e panisëshme...”, Përlëshorja parakremtuese: “Përgatitu, Zabulon...” dhe e shenjtit të kishës.

SHKURTORJA parakremtuese: “Në Jordan afrohet sot...”.

~~~~~

APOSTULLI i së dielës para Theofanisë (2 Tim. 4:5-8).

UNGJILLI i së dielës para Theofanisë (Mk. 1:1-8).  
Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.  
“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

**4. E HËNË.** Mbledhja liturgjike për shtatëdhjetë apostujt. Oshënar Theoktisti. Shën Apolinaria, senatore.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

Nëse pas Mëngjesores nuk kryhet Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore, atëherë leximet biblike lexohen në fund të Mëngjesores:

APOSTULLI i së hënës së javës së 31-të të Letrave (Heb. 11:17-31).

UNGJILLI parakremtues (Kërkoje të Hënën e Ndrithme - Jn. 1:18-28).

Nëse pas Mëngjesores kryhet Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore, atëherë Apostulli dhe Ungjilli lexohen në Liturgji.

~~~~~

Të **hënën në mbrëmje** kryhet MBRËMËSORJA e përditshme e datës 5. Përlëshorja parakremtuese: “Mbajti valët dhe qëndroi...” (Kremtore, fq. 482), psalet vetëm 1 herë.

## **5. E MARTË. Dëshmor Theopemti dhe Theonai.**

Të martën në **mëngjes**, kryhet:

MËNGJESORJA e përditshme e datës 5. Përlëshorja parakremtuese: “Mbajti valët dhe qëndroi...” (Kremtore, fq. 482), psalet vetëm 1 herë. Në fund të Mëngjesores bëhet Përlëshimi i madh.

Në vazhdim kryhet:

Shërbesa e ORËVE TË MËDHA TË THEOFANISË (shih Librin e të Kremteve të Mëdha, fq. 133).

MBRËMËSORJA E MADHE E SË KREMTES SË THEOFANISË DHE LITURGJIA E SHËN VASILIT TË MADH.

“E BEKUAR është Mbretëria e Atit...”, “Ejani t’i falemi...” (3 herë), PSALMI NISTOR (Ps. 103) dhe PAQËSORET.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 4 Vargëzimet e vetëmelodishme të së kremtes, të cilat bëhen 6 (dy të parat thuhën nga 2 herë): “Dritën tonë, që

~~~~~

ndriçoi...”. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes: “Ia ule kryet Pararendësit...” (shih Librin e të kremteve të mëdha, fq. 150-151).

HYRJA me Ungjill. “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe thuhën menjëherë leximet biblike, bashkë me troparet.

Në Mbrëmësoren e Theofanisë janë caktuar të thuhën 13 lexime nga Dhiata e Vjetër, por, në praktikën e sotme liturgjike, lexohen vetëm tre, si në çdo Mbrëmësore tjetër. Ndërmjet leximeve psalen edhe tropare. Radha e leximeve dhe e tropareve është si më poshtë:

Në fillim thuhet leximi I (Gjen. 1:1-13) dhe pas tij psalen troparet: “U fanese në botë...”, bashkë me vargjet nga psalmi 66. Pas çdo vargu, koret psalin fundin e troparit: “që të ndriçosh ata që rrinin...”. Në fund thuhet: “Lavdi...” dhe “Tani...”, dhe psalet sërish i gjithë tropari: “U fanese në botë...”. Pastaj thuhet leximi V (4 Mbret. 2:6-14) dhe pas tij psalen troparet: “Te mëkatarët dhe kumerqarët...”, bashkë me vargjet nga psalmi 92. Pas çdo vargu, koret psalin fundin e troparit: “Se ku gjetkë kish...”. Në fund thuhet: “Lavdi...” dhe “Tani...”, dhe psalet sërish i gjithë tropari: “Te mëkatarët dhe kumerqarët...”. Dhe më pas thuhet leximi VI (4 Mbret. 5:9-14).

~~~~~

Pas leximit VI thuhet: “Le t’i lutemi Zotit...”, “Se i shenjtë je, o Perëndia ynë, dhe Ty ta drejtojmë...”. Dhe koret psalin Himnin trishenjtor: “Shenjt Perëndi...” (kësisoj, ka nisur Liturgjia e Shën Vasilit).

APOSTULLI i Mbrëmësore (1 Kor. 9:19-27).

UNGJILLI i Mbrëmësore (thuhet edhe në Orën IX – Llk. 3:1-18).

Dhe vazhdon Liturgjia e Shën Vasilit të Madh.

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet tropari “Me të gëzohet, o Hirplote...”.

KUNGATORJA: “Lavdëroni Zotin...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

### Shërbesa e SHENJTËRIMIT TË MADH TË UJIT.

Pas uratës së Pasamvonës: “Ti që pranove këtë therore shpirtërore...” dhe para se të thuhet tropari: “Emri i Zotit...”, psalen troparet e vetëmelodishme: “Zëri i Zotit...” etj. dhe kryhet Shërbesa e Shenjtërimit të Madh të Ujit nga kryepriifti ose, në mungesë të tij, nga priifti meshues (kërkoje te Libri i të kremteve të mëdha, fq. 157). Në fund të shërbesës, kryepriifti ose priifti zhyt tri herë në ujin e shenjtëruar Kryqin e nderuar, duke e mbajtur atë drejt, dhe njëherësh psal

~~~~~

Përlëshoren e së kremtes: “Në Jordan kur pagëzoheshë...”, të cilën e përsërisin edhe koret. Më pas, kryepriifti ose priifti spërkat besimtarët me ujin e shenjtëruar duke psalur Shkurtoren e së kremtes: “U fanese me lavdi...”. Në vazhdim, besimtarët afrohen me radhë dhe me qetësi që të spërkaten me ujin e shenjtëruar, ndërkohë kori psal troparin e vetëmelodishëm: “Le të himnojme, o besnikë...”.

Më pas psalet tropari: “Emri i Zotit qoftë i bekuar...” (3 herë) dhe më pas bëhet PËRLËSHIMI: “Ai që pranoi të pagëzohej në Jordan nga Joani për shpëtimin tonë, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë...”.

## **6. E MËRKURË. SHFAQJA E ZOTIT, PERËNDISË DHE SHPËTIMTARIT TONË JISU KRISHT (THEOFANIA).**

### **Në Mëngjesore:**

Pas gjashtë psalmeve, te “PERËNDIA ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e së kremtes: “Në Jordan kur pagëzoheshë...” (3 herë).

NDENJËSORET e së kremtes, sipas radhës. SHKALLESAT: “Që prej rinisë sime...” dhe PARAVARGU i së kremtes: “Deti pa dhe iku...”.

~~~~~

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i së kremtes (Mk. 1:9-11).

Pas Ungjillit lexohet PSALMI 50. Dhe më pas thuhet: “Lavdi...”, tropari: “Sot le të ngazëllehet...”. “Tani...”, po ai: “Sot le të ngazëllehet...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i vetëmelodishëm i së kremtes: “Fjala Perëndi u shfaq me trup...” (Libri i të kremteve të mëdha, fq. 169).

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e së kremtes. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET dyshe: “E teri, e thau fare detin...” dhe: “Shkoi nëpër detin...”.

MADHËSHTIMET: Pas Këngës VIII thuhet thirrja: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...” dhe, në vend të: “Më të nderuarën...”, psalet Kënga IX e të dy kanoneve (kërkoji te Libri i të kremteve të mëdha, fq. 173) dhe në fund thuhet dy irmoset e Këngës IX: “Asnjë gjuhë në botë...” dhe: “O çudi pa fund...”.

DËRGIMSORJA e së kremtes (3 herë).

LAVDËRIMET: Fillohet nga vargu: “Kjo lavdi do të jetë për të gjithë...” dhe psalen 5 Vargëzimet e vetëmelodishme të së kremtes, të cilat bëhen 6, duke thënë të parin dy herë: “Dritë prej drite...”. “Lavdi...”, e së kremtes: “U rrethove nga ujërat në Jordan...”. “Tani...”, “Sot Krishti erdhi në Jordan...”



~~~~~  
(kërkoji të gjitha te Libri i të kremteve të mëdha 175-176).

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e së kremtes (1 herë).

### **Në Liturgji:**

ANDIFONET e së kremtes.

HYRTORJA e së kremtes: *“I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit. Perëndia është Zoti dhe u shfaq ndër ne. Shpëtona, o i Bir’ i Perëndisë, që u pagëzove prej Joanit në Jordan, ne që të psalim: Aliluia”.*

Pas HYRJES psalet Përlëshorja e së kremtes: “Në Jordan kur pagëzoheshë...” dhe Shkurtorja: “U fanese me lavdi...”.

Në vend të Himnit trishenjtor: “Shenjt Perëndi...”, psalet: “SA U PAGËZUAT...”

APOSTULLI i së kremtes (Tit 2:11-14, 3:4-7).

UNGJILLI i së kremtes (Mtth. 3:13-17).

Dhe vazhdon, si zakonisht, Liturgjia Hyjnore e Shën Joan Gojartit.

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet Madhështimi i së kremtes: “O shpirt, madhështoje... O çudi pa fund...”.

KUNGATORJA e së kremtes: “U shfaq hiri i Perëndisë...”.

~~~~~

Në vend të “PAMË DRITËN...”, psalet Përlëshorja e së kremtes: “Në Jordan kur pagëzoheshe...”.

SHENJTËRIMI I MADH I UJIT: Pas lutjes së Pasamvonës, psalet “Zëri i Zotit...” dhe kryhet shërbesa e Shenjtërimit të Madh të Ujit si dje. Në fund psalet Shkurtorja: “U fanese me lavdi...” dhe më pas thuhet: “Emri i Zotit...” dhe bëhet Përlëshimi si në Mbrëmësore.

## **7. E ENJTE. Mbledhja liturgjike për Joan Pagëztorin. Dëshmori i ri Athanas. Oshënar Sidi.**

### **Në Mbrëmësore:**

“I BEKUAR është Perëndia ynë...”, “Ejani t’i falemi...” (3 herë), PSALMI NISTOR (Ps. 103) dhe PAQËSORET.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 3 Vargëzimet e vetëmelodishme të së kremtes: “Dritën tonë, që ndriçoi...” dhe Vargëzimet e përshembullta të shenjtit: “O Pararendës i lavdëruar i Krishtit...”. “Lavdi...” e shenjtit: “Kandil i mishëruar, Pararendës i Shpëtimtarit...” (Libri i të kremteve të mëdha, fq. 178-179). “Tani...”, e së kremtes: “Fjala Perëndi u shfaq me trup...” (tropari i vetëmelodishëm pas psalmit 50, Libri i të kremteve të mëdha, fq. 169).

~~~~~

HYRJA me temjanicë dhe tropari: “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”.

PARAVARGU I MADH: “Perëndia ynë është në qiell dhe në tokë. Ai bëri gjithçka që deshi”, bashkë me këto tri vargje:

Vargu I: “*Kur doli Izraeli nga Egjipti, shtëpia e Jakovit*”.

“Perëndia është...”.

Vargu II: “*Deti pa dhe iku, Jordani u kthye pas*”.

“Perëndia është...”

Vargu III: “*Ç’pate ti, o det, që ike? Ç’pate ti, o Jordan, që u ktheve pas?*”.

“Perëndia është...”

PASVARGJET e përshembullta: “Shën Joan Pararendës...” (Kremtore, fq. 498), bashkë me këto vargje:

Vargu I: “*Deti pa dhe iku, Jordani u kthye pas*”.

Vargu II: “*Ç’pate ti, o det, që ike? Ç’pate ti, o Jordan, që u ktheve pas?*”.

“Lavdi...”, e shenjtit: “Si dashamir i Shpirtit të Shenjtë...”. “Tani...”, e së kremtes: “Ejani të imitojmë virgjëreshat e urta...” (shih Librin e të Kremteve të Mëdha, fq. 180).

PËRLËSHORJA e së kremtes: “Në Jordan kur pagëzoheshë...”. “Lavdi...”, e shenjtit: “I drejti

~~~~~

kujtohet kudo me këngë...”. “Tani...”, e së kremtes: “Në Jordan kur pagëzoheshe...”.

**PËRLËSHIMI:** “Ai që pranoi të pagëzohej në Jordan nga Joani për shpëtimin tonë, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë... të Nderuarit, të Lavdëruarit, Profetit, Pararendësit dhe Pagëzorit Joan, kujtimin e të cilit kremtojmë sot...”.

### **Në Mëngjesore:**

Pas gjashtë psalmeve, te “PERËNDIA ËSHTË ZOTI...”, Përlëshoret thuhet si në Mbrëmësore.

**NDENJËSORET** e së kremtes: Kur lindi Jisu Krishti...” dhe: “Kur të pa, o Zoti Krisht...”, ku secila prej tyre thuhet dy herë, me “Lavdi...” dhe “Tani...” herën e dytë (Kremtore, fq. 499).

Meqenëse nuk ka Ungjill mëngjesor, menjëherë pas Ndenjësove lexohet PSALMI 50.

Pas Psalmi 50 thuhet: SHKURTORJA, SHTËPIA dhe SINAKSARI i ditës (Kremtore, fq. 500).

**ZBRITËSORET** e dyta: “Shkoi nëpër detin...”.

**MADHËSHTIMET:** pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, në vend të: “Më të nderuarën...”, psalen Madhështimet e së kremtes dhe Zbritësorja IX: “O çudi pa fund e lindjes...”.

~~~~~

DËRGIMSORET e shenjtit: “Si Profetin më të madh...” dhe të së kremtes “Na u shfaq Shpëtimtari Krisht...”.

LAVDËRIMET: psalen 5 Vargëzimet e vetë-melodishme të së kremtes, të cilat bëhen 6, duke thënë të parin dy herë: “Dritë prej drite...”. “Lavdi...”, e shenjtit: “Engjëll prej beronjës...”. “Tani...”, e së kremtes: “Sot Krishti vajti në Jordan...” (Kremtore, fq. 504).

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e së kremtes: “Në Jordan kur pagëzohesh...”.

### **Në Liturgji:**

ANDIFONET dhe Hyrtorja e së kremtes, njëlloj si dje.

Pas HYRJES thuhet Përlëshorja e së kremtes: “Në Jordan...”, e shenjtit: “I drejti kujtohet...” dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja e së kremtes: “U fanese me lavdi...”.

Në vend të Himnit trishenjtor: “Shenjt Perëndi...”, psalet: “SA U PAGËZUAT...”.

APOSTULLI i Pararendësit (Vep. 19:1-8).

UNGJILLI i Pararendësit (Jn. 1:29-34).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet “O shpirt, madhështoje...” dhe “O çudi pa fund...”

~~~~~

KUNGATORJA e shenjtit: “I drejti do të kujtohet...”.

Në vend të: “PAMË DRITËN...”, psalet Përlëshorja e së kremtes: “Në Jordan...”.

Dhe vazhdon pjesa e mbetur e Liturgjisë.

Përlëshimi si në Mbrëmësore.

**Shënim:** *Nga nesër dhe deri në datën 13, në Mëngjesore psalen Zbritësoret e dyta: “O çudi pa fund...”. Deri në datën 14 thuhet Shkurtorja e së kremtes: “U fanese me lavdi...”.*

*Në Liturgjinë Hyjnore thuhet Andifonet e së kremtes, por thuhet Hyrtorja e zakonshme: “Ejani t’i falemi... Shpëtona, o i Bir’ i Perëndisë... që u pagëzove prej Joanit në Jordan...”.*

**8. E PREMTE.** Oshënar Gjergj Hozeviti. Oshënar Agathoni. Oshënares Domnika. Shën Alberti i Kashelit.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

Nëse pas Mëngjesores nuk kryhet Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore, atëherë leximet biblike lexohen në fund të Mëngjesores:

~~~~~

APOSTULLI i së premtës së javës së 31-të të Letrave (Jak. 2:1-13).

UNGJILLI paskremtues (kërkoje të Shtunën e Ndrithme – Jn. 3:22-23).

Nëse pas Mëngjesores kryhet Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore, atëherë Apostulli dhe Ungjilli lexohen në Liturgji.

**9. E SHTUNA PAS THEOFANISË.** Dëshmor Poliefki. Oshënar Efstrati, mrekuilibërës. Dëshmore Andonina.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

Nëse pas Mëngjesores nuk kryhet Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore, atëherë leximet biblike lexohen në fund të Mëngjesores:

APOSTULLI i së shtunës pas Theofanisë (kërkoje të dielën e 27 - të Letrave - Efes. 6:10-17).

UNGJILLI i së shtunës pas Theofanisë (Mtth. 4:1-11).

Nëse pas Mëngjesores kryhet Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore, atëherë Apostulli dhe Ungjilli lexohen në Liturgji.

~~~~~

**10. E DIELA PAS THEOFANISË.** Shën Grigori  
i Nisës. Shën Theosevia, dhjakoneshë. Shën  
Dometiani i Melitinës.

**Tingulli Tërthor II. Ungjilli Mëngjesor Ngjallësor IX.**

**Në Mbrëmësore:**

“I BEKUAR është Perëndia ynë...”. “Ejani t’i  
falemi...” (3 herë), PSALMI NISTOR (Ps. 103) dhe  
PAQËSORET.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 6 Vargëzime  
ngjallësore dhe 4 Vargëzime të së kremtes: “Dritën  
tonë, që ndriçoi...”. “Lavdi...”, e së kremtes. “Tani...”,  
Hyjlindësorja dogmatike e Tingullit Tërthor II: “Cili  
nuk do të të lumërojë...”.

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë  
gazmore...” dhe paravargu i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e  
së kremtes.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Fuqitë engjëjlore...”.  
“Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes: “Në Jordan...”.

PËRLËSHIMI: “Ai që pranoi të pagëzohej në  
Jordan prej Joanit për shpëtimin tonë dhe që u ngjall  
së vdekurish, Krishti, Perëndia ynë i vërtetë...”.



---

## **Në Mëngjesore:**

Pas gjashtë psalmeve, te “PERËNDIA ËSHTË ZOTI...”, Përlëshorja ngjallësore: “Fuqitë engjëllore...”. “Lavdi...”, po ajo: “Fuqitë engjëllore...”. “Tani...”, e së kremtes: “Në Jordan...”.

NDENJËSORET ngjallësore, por në vend të Hyjlindësoreve të çdo stikologjie (grupi), psalen Ndenjësoret e së kremtes.

BEKIMTORET ngjallësore. DËGJIMI, SHKALLESAT dhe PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA ngjallësore. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “Shkoi nëpër detin...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor IX.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmit 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Kur u ngrit Jisui...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe Zbritësorja IX: “O çudi pa fund...”.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore IX dhe e së kremtes.

~~~~~

LAVDËRIMET: psalen 4 Vargëzime ngjallësore dhe 4 Vargëzimet e së kremtes: “Dritë prej drite...”, bashkë me këto dy vargjet e fundit:

Vargu I: “*Deti pa dhe iku, Jordani u kthye pas*”.

Vargu II: “*Ç’pate ti, o det, që ike? Ç’pate ti, o Jordan, që u ktheve pas?*”.

“Lavdi...”, Lavdia mëngjesore ngjallësore IX. “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe “Sot erdhi shpëtimi...”.

### **Në Liturgji:**

ANDIFONET e së kremtes bashkë me refrenet e tyre (refreni i dytë: “Shpëtona... që u pagëzove prej Joanit në Jordan...” – refreni i tretë: “Në Jordan kur pagëzoheshe...”.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona, o i Bir’ i Perëndisë, ***që u ngjalle së vdekurish***, ne që të psalim: Aliluia”.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Fuqitë engjëjlore...”, e së kremtes: “Në Jordan...” dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja e së kremtes: “U fanese me lavdi...”.

APOSTULLI i së dielës pas Theofanisë (Efes. 4:7-13).

~~~~~  
UNGGJILLI i së dielës pas Theofanisë  
(Mtth. 4:12-17).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

Përlëshimi si në Mbrëmësore.

**11. E HËNË.** Oshënar Theodhos Kinovjarku.  
Oshënar Vitali në Gaza. Oshënore Etenia.

### **Në Mbrëmësore:**

“I BEKUAR është Perëndia ynë...”, “Ejani t’i falemi...” (3 herë), PSALMI NISTOR (Ps. 103) dhe PAQËSORET.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të shenjtit, të cilat bëhen 6 (thuhet të tria nga 2 herë). “Lavdi...”, e shenjtit. “Tani...”, tropari paskremtues: “Ia ule kryet Pararendësit...” (shih Librin e të kremteve të mëdha, fq. 151).

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, PARAVARGU i ditës dhe LEXIMET biblike (**Leximi I:** Urt. Sol. 3:1-9; **Leximi II:** Urt. Sol. 5:15-6:3; **Leximi III:** Urt. Sol. 4:7-15)

~~~~~

PASVARGJET e shenjtit, bashkë me vargjet e tyre:  
Vargu I: “*Vdekja e oshënarit është e nderuar përpara Zotit*”.

Vargu II: “*Lum ai njeri që e ka frikë Zotin*”.

“LAVDI...”, e shenjtit. “TANI...”, tropari paskremtues:

Tingulli IV – E Joan Murgut

*Ushtritë e engjëjve mahniteshin kur të shihnin sot,  
o Shpëtimtar, të qëndroje i zhveshur në ujërat e  
Jordanit, të përkuļje kokën e pacenuar dhe të  
pagëzoheshe prej Joanit, se kur Ti u varfërove  
vullnetarisht, bota u pasurua, o Zot, lavdi më Ty.*

PËRLËSHORJA e shenjtit: “Me lot të derdhur si rrëke...”. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Përlëshorja e së kremtes: “Në Jordan...”.

**Në Mëngjesore:**

Pas gjashtë psalmeve, te “PERËNDIA ËSHTË ZOTI...”, Përlëshorja e shenjtit: “Me lot të derdhur si rrëke...”. “Lavdi...”, po ajo: “Me lot të derdhur si rrëke...”. “Tani...”, Përlëshorja e së kremtes: “Në Jordan...”.

NDENJËSORET e shenjtit.

SHKALLESAT: “Që prej rinisë sime...” dhe paravargu i shenjtit.

~~~~~

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i shenjtit (kërkoje të premtën e javës së 2-të të Llukait – Llk. 6:17-23).

Pas Ungjillit lexohet PSALMI 50. Pas Psalmit 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e oshënarit...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i shenjtorit.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e shenjtit. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “Shkoi nëpër detin...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe Zbritësorja IX: “O çudi pa fund...”.

DËRGIMSORET e shenjtit.

LAVDËRIMET: psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të shenjtit, të cilat bëhen 4. “Lavdi...”, e shenjtit. “Tani...”, Hyjlindësorja paskremtuese:

Tingulli II – E Anatolit

*Sot Krishti erdhi në Jordan që të pagëzohej. Sot Joani prek kokën e Zotit. Fuqitë qiellore u çuditën kur panë misterin e habitshëm. Deti pa dhe iku. Jordani pa dhe u kthye pas. Por ne të ndriçuarit thërresim: Lavdi Perëndisë që u shfaq, që hodhi sytë mbi tokë dhe ndriçoi botën.*

~~~~~

Dhe vazhdon Dhoksologjia e Madhe nga vargu i dytë: “Të himnojmë, të bekojmë...”.

Pas Dhoksologjisë psalet Përlëshorja e shenjtit.

### **Në Liturgji:**

ANDIFONET e së kremtes

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona, o i Bir’ i Perëndisë, o i çuditshëm ndër shenjtorë, ne që të psalim: Alilua”.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja e së kremtes: “Në Jordan...”, e shenjtit: “Me lot të derdhur si rrëke...” dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja e së kremtes: “U fanese me lavdi...”.

APOSTULLI i shenjtit (kërkoje të dielën e javës së 15-të të Letrave – 2 Kor. 4:6-15).

UNGJILLI i shenjtit (kërkoje të enjten e javës së 4-t të Mattheut – Mthh. 11:27-30).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet “Të meriton...”.

KUNGATORJA: “I drejti do të kujtohet...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

---

**12. E MARTË.** Dëshmore Tatjana, dhjakoneshë.  
Dëshmorët Efthasia, Merti.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

Nëse pas Mëngjesores nuk kryhet Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore, atëherë leximet biblike lexohen në fund të Mëngjesores:

APOSTULLI i së martës së javës së 32-të të Letrave (Jak. 3:1-10).

UNGJILLI paskremtues, i datës 12 janar (Jn. 10:39-42).

Nëse pas Mëngjesores kryhet Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore, atëherë Apostulli dhe Ungjilli lexohen në Liturgji.

**13. E MËRKURË.** Dëshmor Ermili dhe Stratoniku. Oshënar Maksim Kafsokaliviti. Shën Ilari i Puatjesë.

**Mëngjesorja** e përditshme.

Nëse pas Mëngjesores nuk kryhet Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore, atëherë leximet biblike lexohen në fund të Mëngjesores:

~~~~~

APOSTULLI i së mërkurës së javës së 32-të të Letrave (Jak. 3:11-4:6).

UNGJILLI paskremtues (kërkoje të mërkurën e javës së 11-të të Llukait - Llk. 20:1-8).

Nëse pas Mëngjesores kryhet Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore, atëherë Apostulli dhe Ungjilli lexohen në Liturgji.

**14. E ENJTE.** Mbyllja e Theofanisë. Dëshmorët oshënarë në malin Sina dhe në Raitho. Oshënarë Nina. Oshënar Sava.

Shërbesa e Mbylljes (Përlëshimit) të Theofanisë, kryhet njëloj si ditën kryesore të festës (6 janar), por me këto ndryshime:

Në **Mbrëmësore**, gjatë kohës që psalet Lavdia e vargëzimeve të thirrtoreve, bëhet Hyrja, thuhet “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe paravargu i ditës. Leximet biblike të festës nuk thuhen. Përlëshorja e së kremtes, 3 herë. Dhe Përlëshimi si ditën e së kremtes.

Në **Mëngjesore**, nuk psalen Ndenjësoret e stikologjisë (grupit) së tretë, por vetëm dy grupet e para. Nuk thuhet Ungjilli mëngjesor i së kremtes. Pra, pas dy stikologjive (grupeve) të para të Ndenjësoreve, lexohet Psalmi 50 dhe menjëherë pas tij thuhet



~~~~~

Shkurtorja dhe Shtëpia e së kremtes, si dhe Sinaksari i datës 14 janar. Më pas, psalen Zbritësoret dyshe. Pas Këngës VIII, psalen Madhështimet e së kremtes, njëlloj si në datën 6 janar. Nuk kryhet shërbesa e Shenjtërimit të Madh të Ujit.

Në **Liturgji** thuhet Andifonet, Hyrtoja, Përlëshorja dhe Shkurtorja e së kremtes.

Thuhet: “Shenjt Perëndi...”, jo: “Sa u pagëzuar...”.

APOSTULLI i së enjtes së javës së 32-të të Letrave (Jak. 4:7-5:9).

UNGJILLI paskremtues (Kërkoje të shtunën e javës së 5-të të Joanit - Jn. 10:27-38).

Dhe vijon, si zakonisht, Liturgjia e Shën Joan Gojartit.

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet Madhështimi i së kremtes: “O shpirt, madhështoje... O çudi pa fund...”.

KUNGATORJA e së kremtes: “U shfaq hiri i Perëndisë...”.

Në vend të “PAMË DRITËN...”, psalet Përlëshorja e së kremtes: “Në Jordan...”.

**Shënim:** *Nga data 15 janar deri në datën 9 shkurt psalen Zbritësoret e së kremtes së Paraqitjes së Zotit Krisht në Tempull, ndërsa në Liturgji thuhet Shkurtorja e së kremtes së Paraqitjes: O Zot, që e shenjtërove Marinë...” (kërkoje më 2 shkurt).*

---

**15. E PREMTE.** Oshënar Pavli i Tebës. Oshënar Joan Kaliviti dhe Mauri. Dëshmor Pansofi.

**Mbrëmësorja** e përditshme.

**Mëngjesorja** e përditshme.

Nëse pas Mëngjesores nuk kryhet Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore, atëherë leximet biblike lexohen në fund të Mëngjesores:

